



# AKT - THEMELIMI

I

## SHOQERISE TREGTARE

### "GIORGI ALFO" - SHPK

FORMIMI

N e n i 1


Formohet Shoqeria Tregtare "GIORGI ALFO"-shpk e Ortakut te vetem themelues Z. Alfo Giorgi, shtetas italian, lindur me 30/01/1945 ne Piombino, Livorno (Itali) dhe banues ne Vignnale Rio Toreto, Rr. "Del Poggio", n. 22, me pasaporte n. 321400L

N e n i 2

Selia e Shoqerise Tregtare "GIORGI ALFO." do te jete ne Tirane, Rr. "Myslym Shyri", Pll. 124/2, ap. 49.

*Alfo*

### N e n i 3



Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te Shoqerise Tregtare "GIORGI ALFO"-shpk eshte e pakufizuar e mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe sipas vendimeve qe do te marre Ortaku i vetem i Saje.

### N e n i 4

Shoqeria Tregtare "GIORGI ALFO" do te ushtroje nje aktivitet ekonomik sipas pershkrimit qe i behet ne nenin Nr. 4 te Statutit te saje.

Shoqeria eshte person Juridik dhe veprimtaria e saje do te ushtrohet ne baze te ligjit nr.7512 dt.10/8/1991, ne baze te Ligjit 7638 dt.19/11/1992 dhe ne baze te Statutit te miratuar nga Ortaku i Vetem .Per problemet qe nuk jane trajtuar ne kete akt themelues e ne Statut do te zbatohet Kodi Tregtar.

Shoqeria pergjigjet per detyrimet e veta vetem me pasurine e saje te krijuar gjate veprimtarise se saje ekonomike.

## K A P I T A L I I S H O Q E R I S E

### N e n i 5

Kapitali themeltar i Shoqerise Tregtare "GIORGI ALFO" shpk eshte 100.000 lek, i investuar ne masë të plotë nga Ortaku i vetem i saj z. Alfo Giorgi.

Ky kapital mund te ndryshoje ne baze te vendimeve qe do te marre ortaku i vetem i Shoqerise.

### N e n i 6

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i aktivitetit ekonomik i shoqerise do te administrohet nga Ortaku i vetem i Shoqerise. Nje pjese tije do te perdoret per shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe te detyrimeve ndaj te treteve.

*Alfo*

N e n i 7

Administrator dhe Perfashues i Shoqerise Tregtare " GIORGI ALFO" eshte ortak i vetem i Shoqerise Z. Alfo Giorgi.

N e n i 8

Ne statutin qe i bashkengjitet ketij Akt-Themelimi jane te percaktuara te gjitha kerkesat ligjore per ushtrimin e aktivitetit te Shoqerise.

N e n i 9

Mosmarveshjet qe do te lindin midis Shoqerise dhe personave te punesuar ne te n.q.s nuk zgjidhen ne mirkuptim do te jete kompetente Gjykata e Rrethit Tirane.

N e n i 10

Ky Akt- themelimi se bashku me Statutin perpilohen ne disa kopje dhe i shperndahen organeve kompetente, per te bere rregjistrimin si person Juridik te saje.

Tirane 19/1 /1996

ORTAKU I VETEM  
SHOQERISE TREGTARE  
"GIORGI ALFO" - SHPK

ALFO GIORGI

*Giorgi Alfo*

*Alfo*



# STATUTI

I

## SHOQERISE TREGTARE

### "GIORGI ALFO" SHPK

#### FORMIMI

##### Neni 1

Formohet Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "GIORGI ALFO" shpk e Ortakut te vetem themelues Z. Alfo Giorgi , ne perputhje me Aktin Themelues te dates / /1996, pjese perberese e te cilit eshte ky Statut.

#### SELIA

##### Neni 2

Shoqeria Tregtare "GIORGI ALFO" shpk ka seline e saje ne Tirane, Rr. "Myslym Shyri", Pll. 124/2, ap. 49.

Kjo shoqeri mund te hape edhe filiale te tjera te dyta e operative, perfaqsi e agjensi ne te gjithë teritorin e Shqiperise si dhe jashte saje ne perputhje me ligjet ne fuqi te vendit ku ato do te hapen.



## K O H E Z G J A T J A

### N e n i 3

Shoqëria Tregtare "GIORGI ALFO" ka një kohezgjatje të veprimtarisë së sajë ekonomike të pakufizuar e mbi 10 vjet. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë sipas vendimeve që do të marrë Ortaku i vetëm i sajë.

## O B J E K T I I V E P R I M T A R I S E

### N e n i 4

Objekti i veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë Tregtare "GIORGI ALFO" shpik është për sa vijon:

- aktiviteti turistik dhe investime në fushën e turizmit, hoteleri, bar-restorante, motel;
- veprimtari tregtare në fushën e ushqimit social;
- veprimtari në fushën e transporteve të ndryshme të mallrave e udhëtareve, përfshi shërbime tranzitimi në porte e pika kufitare të Shqipërisë;
- operacione financiare për llogari të treta;
- veprime factoring e leasing;
- operacione burse;
- realizimi i infrastrukturave si: (porte, rrugë, ura, hekurudha, punime nenujore, ndertime publike e private si dhe import eksport materialeve të ndërtimit);
- tregtim i letrave me vlerë dhe i obligacioneve në çdo treg, operacione kambizmi të valutave të ndryshme;
- lokacione, blerje dhe shitje të pasurive të luajtshme e të paluajtshme.

## K A P I T A L I I S H O Q E R I S E

### N e n i 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë Tregtare "GIORGI ALFO" shpik është 100.000 lek, i investuar në masë të plotë nga Ortaku i vetëm i saj z. Alfo Giorgi.

*Alfo*



## N e n i 6

Kapitali i Shoqërisë mund të shtohet e të pakesohet sipas rregullimeve që do të marrë Ortaku i vetëm i shoqërisë dhe sipas ligjeve në fuqi.

## D R E J T I M I D H E A D M I N I S T R I M I

## N e n i 7

Shoqëria Tregtare "GIORGI ALFO" shpk deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut e Akti Themelues si dhe ato të legjislativës shqiptare në fuqi.

## N e n i 8

Shoqëria Tregtare "GIORGI ALFO" shpk është prone e ortakut të vetëm Z. Alfo Giorgi, i cili gëzon të gjitha atributet e Asamblesë së Shoqërisë, si dhe është Administrator i sajë.

## N e n i 9


Shoqëria Tregtare fiton zotesinë për të vepruar me njohjen e sajë si person juridik nga Gjykata e Rrethit të Tiranës dhe me rregjistrimin e sajë si Subjekt privat në Organin përkatës tatimor të Tiranës.

## N e n i 10

Shoqëria Tregtare "GIORGI ALFO" ka vullnet të sajë me përmbajtjen : "SHOQËRIA TREGTARE GIORGI ALFO SHPK TIRANË". Ajo ka inteshtimin e sajë si dhe llogari bankare në Lek dhe në Valutë në Bankat e Shqipërisë.

*gaffi*

## N e n i 11



Shoqeria Tregtare vepron ne rregjimin e prones private te parimeve te llogarive ekonomike dhe te ekonomise se tregut. Ajo gezon te drejten te mbroje pasurine e saje private sipas kushteve e ligjeve shqiptare ne fuqi.

## N e n i 12

Shoqeria merr persiper te drejta e detyrime kontraktore e jashte kontraktore brenda kapitalit te saje themelor. Ortaku i vetem bart rrezikun per veprimtarine ekonomike te Shoqerise dhe detyrimet e saje ndaj te treteve, brenda kapitalit te saj themelor duke mos u pergjigjur per keto detyrime me pasuri te fituara ne aktivitete te tjera ekonomike jashte kesaj Shoqerie.

## N e n i 13

Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e Shoqerise Administratori puneson punetore dhe emerom administratore te cilet qendrojne ne detyre derisa revokohen nga Shoqeria ose largohen me deshiren e tyre pas perfundimit te kontrates se punesimit.

Administratori i emeruar i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer te Shoqerise ne mardhenie me te tretet me perjashtim te kompetencave qe ligji i jep shprehimisht pronarit te Shoqerise.

## N e n i 14

Administratori eshte i veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem e te jashte zakonshem te shoqerise pa asnje kufizim apo perjashtim .

Ne raste kur detyren e Administratorit e kryen administratori i emeruar ai eshte i detyruar te njoftoje e ti jape llogari Administratorit per kryerjen e detyrave te ngarkuara.

*QAF*

## MARDHENIET E PUNES

### N e n i 15

Mardheniet e punes ne Shoqerine Tregtare "GIORGI ALFO" rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtje qe nuk rregullohen nepermjet saj zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

### N e n i 16

Cdo te punesuari ne Shoqerine Aktin e emerimit i percaktohet detyra dhe paga. Shoqeria merr persiper t'i siguroje cdo te punesuari respektimin e ligjeve e rregullave te punesimit e te sigurimeve shoqerore, ndersa te gjithë te punesuarit jane te detyruar te pranojne kete statut.

### N e n i 17

Te gjithë te punesuarit ne kete Shoqeri pergjigjen sipas ligjit dhe sipas ketij Statuti per moszbatimin e detyrave te ngarkuara nga administratori apo nga personat e autorizuar prej tij.

### N e n i 18

Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit nese ne kontraten e punes nuk parashikohet ndryshe.

### N e n i 19

Administratori i emeruar nuk mund te marre cilesine e ortakut ne Shoqeri as edhe te ushtroje nje aktivitet tjeter konkurrues te cfardolloji per llogari te tije apo te te treteve, pervec atyre te autorizuar nga administratori i pergjithshem i Shoqerise. Per cdo shkelje ne kete drejtim Administratori i emeruar largohet nga puna dhe pergjigjet per demet qe i ka shkaktuar shoqerise.

*Alfio*



SEKRETI I PUNES

Neni 20

Te gjithë te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes ne Shoqeri. Kjo detyre vazhdon edhe pas largimit te tyre nga kjo Shoqeri.

PERFAQSIMI I SHOQERISE

Neni 21

Perfaqsimimi i Shoqerise Tregtare "GIORGI ALFO" i perket administratorit te saje Z. Alfo Giorgi, dhe/ose personave nga ai te autorizuar.

KONTROLI I BRENDSHEM

Neni 22

Shoqeria Tregtare organizon kontrollin e brendshem nepermjet eksperteve kontal te autorizuar, te cilet kontrollojne zbatimin e ligjishmerise dhe inventaret vjetore te pasurise.

Ata jane pergjegjes para Shoqerise dhe para te treteve per demet qe i shkaktojne Shoqerise nga moskryerja ne rregull te detyres se tyre.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 23

Veprimet ekonomike e financiare te Shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti. Administratori i Shoqerise nxjerr bilancin kontabel me llogarine Humbje-Fitime, inventaret dhe raportet perkates, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kontabilitetin, si dhe harton raport me shkrim per administrimin.

*GAFFIN*

Raporti i administrimit, inventaret, bilancet dhe llogaritjetore te hartuara nga administratori i nenshtrohen miratimit te Ortakut te vetem pas raportit te eksperteve kontabel te autorizuar, brenda afatit prej tre muajsh nga data e mbylljes se bilancit financiar.

Me miratimin e bilancit kontabel vjetor Ortaku i vetem vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme per zhvillimin e saj si fondin rezerve, ate te akumulimit etj. Per rezerva financiare caktohet 5 perqind e fitimit (Zbritjet humbjet eventuale te vitit te meparshem te pambuluar), perderisa ky fond te arrije sa 10 perqind e fondit themelor. Pas ketij niveli kuota e rezervimit vjetor eshte e lire.

#### N e n i 24

Te ardhurat neto, pas vecimit te fondeve si me siper dhe dhe shlyerjes se detyrimeve fiskale, i mbesin per perdorim ortakut te vetem te Shoqerise,

### S H P E R B E R J A E S H O Q E R I S E

#### N e n i 25

Shperberja e Shoqerise Tregtare mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, si ne rast falimentimi, privimi te drejtave per te ushtruar profesion tregtar, forca madhore, ne rast lufte dhe cdo faktor tjeter qe nuk varet nga vullneti i Ortakut te vetem te Shoqerise.

Ne keto raste, Administratori vendos mbi menyren e likuidimit te Shoqerise, duke caktuar nje ose me shume likuidatore .

Ne rast likuidimi te Shoqerise, emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER".

Likuidatoret dhe administratoret jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise shoqerore, perderisa t'iu dorezohet personave perkates fizike e juridike, duke likuiduar detyrimet e shoqerise ndaj te treteve, ne rradhe te pare.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitelit themeltar kontribuesve perkates, likuiduesi i kalon kapitalin e mbetura ortakut te vetem te Shoqerise.

Ne fund te procesit te likuidimit, Ortaku i vetem vendos mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuiduesve dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit.

*Gaffio*

Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likuidimit dhe kryhen formalitetet e likuidimit, Shoqeria c'rregjistrohet nga Regjistri Qendror i Gjykates se Rrethit te Tiranes.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 26

Statuti dhe Akti i Themelimit te Shoqerise perpilohet ne disa kopje per ti u shperndare organeve kompetente per te berre rregjistrimin e saje si subjekt privat dhe njohjen si Person Juridik. Nje kopje e saje mbete si pjese e dokumentacionit te themelimit te Shoqerise.

Statuti firmoset rregulisht nga Ortaku i vetem dhe administratori i saje Z. Alfo Giorgi.

ORTAK I VETEM

TIRANE 19/1/1996

Alfo Giorgi

